



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 493

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 397, NGA Z.IVI KASO PËR AFISHIM TË MATERIALIT PROPAGANDISTIK TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", NË BASHKINË DIBËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 11.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

**KËRKUES:** z. Ivi Kaso

**OBJEKTI:** Kërkohet marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, neni 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me nr. 397 ID, datë 5.5.2023, me denoncues z. Ivi Kaso.

Z. Kaso pretendon se: "Në Bashkinë Dibër janë vendosur postera të kandidatit të Partisë Socialiste, njëkohësisht dhe kryetar i bashkisë jashtë vendeve të përcaktuara për afishimet

Data: 11.5.2023 Nr: 493  
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 397, nga z.Ivi Kaso për afishim të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", në bashkinë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

*elektorale, si dhe po përdorën automjetet e bashkisë për vendosjen e posterave. Denoncimi është shoqëruar me pamje filmike”.*

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Në vijim të procedurës administrative, KQZ filloi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga monitoruesi i caktuar nga KQZ-ja për monitorimin e Bashkisë Dibër, informacion në lidhje me afishimin e materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Nga informacioni i dërguar nga monitoruesit rezultoi se afishimi i materialit propagandistik është bërë në një distancë brenda 5 (pesë) metrave nga zyra kryesore e Partisë Socialiste, por nuk përmban shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor). Materiali propagandistik është afishuar tek Bulevardi “Elez Isufi”, ish Godina e Komitetit, Dibër.

Raporti i dërguar nga monitoruesi është i shoqëruar me foto të materialit propagandistik.

Gjithashtu nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u kqyrën pamjet filmike të dërguara nga z. Kaso, në të cilin vërehet se automjeti i cili po vendos materialet propagandistike nuk ka logo të bashkisë. Nga pamjet filmike të depozituara nga denoncuesi është e pamundur të identifikohet targa e automjetit për të bërë verifikimet nëse është apo jo automjet i bashkisë.

Në datë 3.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimin nr. 424, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor) nëpërmjet të cilit ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Ky vendim i adresohet të gjithë subjekteve zgjedhore që nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, dhe ngarkon Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për zbatimin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 424, datë 3.5.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i është përcjellë të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit me shkresat nr. 4640 Prot. dhe nr. 4651 Prot., datë 4.5.2023.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raportit të monitoruesit vlerësojmë se materiali propagandistik është në kundërshtim të nenit 79, pika 3, të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, nenin 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Data: 11.5.2023 Nr: 493  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 397, nga z.Ivi Kaso për afishim të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në bashkinë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Dibër, për heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Dibër, për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’u njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Dibër, nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**